



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër
12- Zyrtarisht /2024
Deçan.24.01.2024

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit
Z. Bashkim Ramosaj


Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslijaj

Nga : Shefi i Drejtorisë Z. Hasan Hulaj



Lënda: Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2024 – Dhjetor 2024, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit

Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2024 – Dhjetor 2024, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit



PLAN P UNE

Për periudhën Janar — Dhjetor 2024 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër ne Deçan

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP se bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Meqenëse Drejtoria jone Kryesisht punon ne baze te kërkesave te palëve , nuk kemi mundësi reale qe te caktojmë volumin e punëve për vitin 2024, por ne duke u bazuar ne statistikat qe i mbajnë për çdo vit mendojmë se ne këtë vit do te ketë trend te rritjes se volumit te punëve krahasuar me vitet paraprake.

Ne vazhdim ne baze te punëve te kryera ne vitet e kaluar dhe bazuar ne trendin e rritjes se kërkesave te palëve po japin një pasqyre e cila do na shërbeje si orientim i synimeve te kryerjes se punëve brenda vitit planifikues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP — njëkohësisht Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtarja e Ndërrimeve kadastrale planifikojnë qe ne këtë vit te shqyrtoi përafërsisht 800-920 kërkesa te palëve te cilat kane te bëjnë me ndërrimin e pronareve dhe futjen e te dhënave te reja ne sistemin e SIKTK- es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit te shërbimit i dhe se bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kryejnë edhe pune tjera me urdhër te drejtorit dhe sipas nevojës .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes se Kadastrit

Ne këtë sektor punojnë dy zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjate periudhës 01.01.2024 deri 31.12.2024, mendojmë se do kryejnë afro 355 raste tereni sipas kërkesës se palëve për te cilat do bëjnë azhurnimin adekuat neper librat kadastral dhe me pas për këto lëndë nxjerrin vendime adekuate .

Punët ne teren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se me ligje kjo pune iu është lënë vetëm Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuara.

Gjithashtu. Këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 50 raste te lëshuarjes se Historiateve si dhe do dalin ne teren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare te Komunës.

Te njëjtit do kryej edhe detyra tjera sipas nevojave te cilat paraqiten ne këtë shërbim siç janë lëshuarja e kopjeve të planit konsultat me pale dhe pune tjera ne zyre.

3. Referenti për pranimin e palëve i cili punon me punë shtesë

Gjate kësaj periudhe , referenti për pranimin e palëve mendojmë se do pranoje përafërsisht 4700 kërkesa te cilat kryesisht kane te bëjnë me dhënien e certifikatave te pronës se paluajtshme, kopjeve te planit dhe vërtetimeve me te cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri te paluajtshme, ne territorin e Komunës etj..

I njëjti zyrtar i procedon te gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse ne afatin brenda ditës se paraqitjes se kërkesës.

Ky plan i punës nuk parasheh 100% punët qe do kryhen gjate vitit 2024 por siç u tha edhe me lartë është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar ne statistikat e punëve te kryera nga vitet paraprake i qe shihet se për secilin vit ka tendenca te rritjes volumit te punës.

Raportin e hartoi :

Shefi i kësaj Drejtorie

Hasan Hulaj



Planin e Aprovoi :

Drejtori

Agroni Muslijaj